



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2776/2 prot

Datë 10.11.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM  
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E  
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT  
NGRIHEN PRETENDIME.**

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Adenis Kastrati” P.F. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me REF-84059-10-17-2023 me objekt: “Mobilje druri” me fond limit 2,546,587 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Korçë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “KLAME” SHPK, Nipt, K21518003F  
*Adesa:Rr.Gani Kryeziu, Nr.23 Kati I, Kodër, Kamëz, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes.  
*Adresa:Rruga Dhimitër Denasi, Korçë.*
- Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “Adenis Kastrati” P.F. me Nipt, L51611004I, *Adresa:Rr. Demokracia, Godina Nr.29, kati I ,Lagjja 4, Bathore, Kamëz, Tiranë .*

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me Nr ankimimi A/2023/3586, datë 09/11/2023 dhe Nr.2776/2023 prot, date 09/11/2023 e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me REF-84059-10-17-2023 me objekt: “Mobilje druri” me fond limit 2,546,587 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Korçë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Adenis Kastrati” P.F.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimes “KLAME” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “Adenis Kastrati” P.F. e konkretisht:

**1- Shtojcën 7, KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**  
Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

**2- 2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates, në vlerën jo më pak se 20 % të fondit limit të vënë ne dispozicion.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror dhe faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara / sherbimeve të kryera.  
ose
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara / sherbimeve të kryera.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 10.11.2023.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**